



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4312 Prot

Vlorë, më 21 03 2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 28 mars 2024.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Për dijenë: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

PREFEKTIT TË QARKUT VLORË

Ju njoftoj se, ditën e enjte, datë **28.03.2024, ora 10:00**, në pallatin e kulturës "Labëria" do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas pikave :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë 26.02.2024.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë datë 07.03.2024 dhe datë 13.03.2024.
3. Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 9-17, datë 26.02.2024,

Do të vazhdojmë me këtë Rend Dite:

1. Projektvendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin shkurt 2024"
2. Projektvendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin shkurt 2024".
3. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e banesës së zotit Rivaldo Hekurani dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".

4. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Robert Shëllegaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".
5. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Kristaq Piperi dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".
6. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja e banesës së zotit Deniz Izetaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".
7. Projektvendim "Për vendosjen e një përmendore në territorin e Kishës së Fshatit Porro".
8. Projektvendim "Për një ndryshim në VKB Nr 92, datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024".
9. Projektvendim "Për miratimin e tavanëve përgatitorë për programin buxhetor afatmesëm 2025 – 2027".
10. Projektvendim "Për miratimin e buxhetit faktik 2023".
11. Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 "Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024".
12. Projektvendim "Për një saktësim në Vendimin Nr 96, datë 07.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Vlorë, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024".
13. Të ndryshme.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e martë, datë 26.03.2024, ora 09.30.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e martë, datë 26.03.2024, ora 11.00.

Komisioni për zhvillimin urbanistik dhe ndërtimet, do të mbledhet ditën e martë, datë 26.03.2024, ora 13.00.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

